

INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE I STANDARDEVE

PROGRAMI MËSIMOR

**LËNDA:GJEOGRAFI
GJEOGRAFIA E EVROPËS**

(klasa e shtatë)

Tiranë, 2005

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

- I. HYRJE
- II. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM
- III. OBJEKTIVAT KRYESORË
- IV. PËRMBAJTJA E LËNDËS
- V. METODOLOGJIA E TË MËSUARIT
- VI. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT
- VII. UDHËZIME

I. HYRJE

Programi i ri i lëndës “Gjeografia e Evropës” për klasën e shtatë të shkollës 9-vjeçare është hartuar në përputhje me vizionin e të mësuarit të gjeografisë për nivelin e arsimit të detyruar.

Në klasën e shtatë, studimi përqendrohet në njohjen e elementeve kryesore të gjeografisë së Evropës, si dhe në karakteristikat e përgjithshme gjeografike të shteteve të veçanta sipas rajoneve në të cilat ato ndodhen. Nxënësit njihen me karakteristikat gjeografike të shteteve të Ballkanit dhe të Evropës, duke synuar kështu njohjen e vendeve fqinje, vendeve miq, si dhe në lidhjet e ngushta të Shqipërisë me partnerët e saj ekonomikë.

Nxënësit mësojnë se Shqipëria ka lidhje dhe interesa të shumta sidomos me vendet e rajonit të Ballkanit e të Evropës Perëndimore. Ata mësojnë sesi këto vende ndihmojnë në zhvillimin e Shqipërisë nëpërmjet rrugëve të medias, imigracionit, kulturës, teknologjisë, turizmit, historisë dhe gjeografisë.

Përmbajtja e programit përfshin studimin e veçorive fiziko-gjeografike të Evropës, të rajoneve dhe të vendeve të veçanta.

Në tërësi, programi krijon, gjithashtu, hapësira për studimin e elementeve të gjeografisë humane. Dukuritë humane në gjeografinë e kontinentit Evropian ndihmojnë në formimin e kulturës së përgjithshme të nxënësve, sidomos në kuptimin dhe pranimin e ngjashmërive dhe të ndryshimeve ndërmjet popujve, shteteve dhe rajoneve të ndryshme evropiane.

Në përmbajtjen lëndore, jepen të ndërthurura elementet e gjeografisë politike, (organizimi shtetëror, harta politike), me gjeografinë ekonomike. Përmbajtja e programit është pasuruar më tej edhe me elementet e gjeografisë rurale, gjeografisë urbane, gjeografisë kulturore e të turizmit etj., duke e plotësuar kështu kuadrin e studimit kompleks gjeografik të Evropës.

Struktura e programit është ndërtuar në bazë të kurrikulave bashkëkohore të vendeve më të përparuara të perëndimit. Përbërësit e ndryshëm të kësaj strukture synojnë ta bëjnë këtë program më fleksibël, duke i ndihmuar mësuesit për ta zbërthyer atë në mënyrë krijuese. Përmbajtja është organizuar në kapituj, në tema mësimore, si dhe në punët praktike dhe përsëritjet.

Objektivat e përgjithshëm e kryesorë të të mësuarit, që përfaqësojnë një element tjetër të rëndësishëm të programit, do ta orientojnë mësuesin për të formuluar saktë objektivat specifike për temat dhe çështjet më kryesore të orës së mësimi.

Udhëzimet që jepen në lidhje me metodologjinë e të mësuarit e të vlerësimit, si dhe për zbatimin praktik të këtij programi, kanë karakter ndihmues.

II. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Në përfundim të studimit të kësaj lënde, nxënësit të jenë në gjendje:

1. Të marrin njohuri bashkëkohore gjeografike për Evropën, duke e konceptuar atë si shtëpinë e ardhshme të përbashkët të tyre;

2. Të njohin lidhjet e gjeografisë me shkencat e tjera, sidomos me historinë dhe shkencat politike, sociologjinë dhe antropologjinë, gjeologjinë dhe shkencat ekonomike evropiane.

3. Të njohin prirjet e zhvillimit të hartës së sotme politike të Evropës, në përgjithësi, e të rajoneve të veçanta.

Të kuptojnë se jetojnë në një botë që po ndryshon me shpejtësi, se janë qytetarë të ardhshëm të një brezi të përfshirë në rrjedhat e zhvillimit bashkëkohor

drejt integritet, sigurisë e bashkëpunimit ndërkombëtar, qytetarë të një kontinenti që shkon drejt bashkimit ekonomik, politik e shoqëror.

4. Të formojnë koncepte të qarta për anë të veçanta të dukurive gjeografike, duke nxjerrë në pah rolin e faktorëve natyrorë në popullimin dhe zhvillimin shoqëror e ekonomik të Evropës e të vendeve evropiane.

5. Të njohin pasuritë kryesore natyrore dhe humane, mënyrën e shfrytëzimit të tyre dhe ndikimin e këtij shfrytëzimi në shkallën e ndotjes dhe të degradimit të mjedisit.

6. Të njohin dhe të interpretojnë drejt anë të veçanta të dukurive rajonale gjeoetnokulturore, siç janë: racat, etnitë, gjuhët, besimet, kulturat e ndryshme etj.

7. Të lexojnë, të njohin dhe të interpretojnë drejt e saktë materialet ilustrative, si dhe hartat që shoqërojnë tekstin, duke u aftësuar dhe duke përvehtësuar elementet bazë të tyre, si: emërtimi, shkalla numerike dhe shkalla grafike-lineare, rrjeti i koordinatave, elementet gjeografike bazë të hartës, si: relievi, hidrografia, bimësia, vendbanimet, rrjeti i komunikacionit etj.

8. Të analizojnë dhe të vlerësojnë pozicionin gjeopolitik të vendit tonë në rajonin e Mesdheut, mundësitë e përfshirjes hap pas hapi të Republikës së Shqipërisë në të gjitha rrjedhat euroatlantike, duke nënvizuar dhe duke nxjerrë në pah ndihmesën modeste të kombit tonë për forcimin e paqes e të bashkëpunimit ndërrajonal e më gjerë.

9. Të kuptojnë lidhjet e mjedisit natyror me veprimtarinë jetësore e prodhuese të shoqërisë dhe mbi këtë bazë të dinë dhe të zbatojnë rregullat dhe mënyrat e mbrojtjes së mjedisit.

10. Të përdorin fjalorin e përshtatshëm gjeografik sipas normave të gjuhës së njësuar shqipe dhe standardeve ndërkombëtare të përdorimit të emërtimeve të objekteve, dukurive, proseseve dhe strukturave gjeografike.

11. Të fitojnë njohuri, shprehje dhe vlera që i përkasin fushës së lëndëve shoqërore, ku përfshihet dhe gjeografia shkollore, duke qenë në gjendje:

- të shqyrtojnë dhe të kuptojnë marrëdhëniet dhe kontekstet shoqërore aktuale dhe të kaluara, si edhe të mbajnë qëndrim rreth asaj sesi zgjedhjet që njerëzit bëjnë sot, mund ndikojnë në të ardhmen;
- të kuptojnë konceptet themelore, të cilat bëjnë të mundur kërkimin në mënyrë të pavarur, si dhe të përdorin njohuritë për çështjet shoqërore;
- të zhvillojnë aftësinë e tyre për të përdorur burime të ndryshme të informacionit, si dhe të mbajnë një qëndrim kritik për to;
- të zhvillojnë besimin në aftësitë e tyre për të pasur ndikim dhe dëshirë për të mbrojtur vlerat demokratike, si dhe për t'u njohur me të drejtat dhe detyrimet si qytetarë të një shoqërie demokratike;
- të marrin pjesë në mënyrë aktive në jetën e shoqërisë dhe zhvillimin e saj, si edhe të jenë përgjegjës për mjedisin ku jetojnë;
- të marrin informacione rreth mënyrës sesi kushtet natyrore dhe materiale, si dhe idetë e pikëpamjet kryesore për jetën, formojnë dhe kanë formuar shoqërinë;
- të zhvillojnë aftësitë e të kuptuarit të pikëpamjeve themelore ekzistuese dhe etike për shoqërinë dhe të jenë në gjendje t'i përdorin ato për të formuluar pikëpamjet e veta;
- të zhvillojnë dijet dhe aftësitë e tyre për ta vendosur veten në mënyra të ndryshme jetese dhe të kuptojnë arsyet për ndryshimet në kohë dhe hapësirë, si dhe rreth asaj që është e përbashkët në kultura të ndryshme;

- të zhvillojnë respektin për pikëpamjet e personave të tjerë duke vënë re dhe duke e distancuar veten e tyre nga veprimtaritë të cilat përfshijnë shtypjen dhe dhunën ndaj të tjerëve;
- ta bëjnë zakon të veprimeve të tyre marrjen parasysh të vlerave të barabarta dhe të drejtat e gjithësecilit, pavarësisht nga gjinia, klasa apo përkatësia etnike;
- të zhvillojnë aftësinë për të kuptuar pasojat e pikëpamjeve dhe të veprimeve të tyre dhe të të tjerëve, si dhe të zhvillojnë aftësinë për të vlerësuar sfidat lokale, kombëtare dhe globale shoqërore dhe politike;
- të zhvillojnë arsyetimin për kuadrin ekologjik dhe rrugët e ndryshme të ruajtjes dhe të përdorimit të burimeve;
- të zhvillojnë të kuptuarit e mënyrës si veprimtaritë dhe kulturat pasqyrojnë edhe ndikime të tjera, si për shembull, nga arti, letërsia dhe muzika.

III. OBJEKTIVAT KRYESORË TË LËNDËS

Nxënësit përmes njohurive, interpretimeve, analizave e përgjithësimeve të jenë në gjendje:

1. Të njohin tiparet dhe veçoritë e gjeografike rajoneve e vendeve evropiane, si dhe marrëdhëniet ndërmjet njeriut dhe mjedisit.
2. Të shpjegojnë rolin e faktorëve kryesorë natyrorë që kanë përcaktuar larminë e theksuar të ndërtimit gjeologjik, të relievit, klimës, hidrografisë, tokave, mbulesës bimore e botës shtazore dhe të komplekseve fiziko-gjeografik të një rajoni të caktuar.
3. Të shpjegojnë pozitën gjeostrategjike të kontinentit të Evropës, të rajoneve të mëdha gjeografike, shteteve kryesore, apo zonave të veçanta, lidhjeve tradicionale e konfrontimeve në rrjedhat e historisë dhe prirjet aktuale të integritimit dhe globalizimit ekonomik dhe politik.
4. Të njohim shkaqet e dallimeve shoqërore, ekonomike dhe politike të rajoneve e shteteve të ndryshme dhe faktorët që po kushtëzojnë sot ngushtimin e ndryshimeve shoqërore, ekonomike e politike.
5. Të analizojnë dhe të interpretojnë lëvizjet natyrore dhe hapësinore të popullsisë, strukturën e popullsisë sipas vendbanimeve dhe prirjeve të kohës të urbanizimit dhe industrializimit.
6. Të njohin tiparet dhe veçoritë e organizimit strukturor dhe të shpërndarjes hapësinore të ekonomisë në rajone të veçantë, gjendjen e sotme dhe prirjet e zhvillimit në të ardhmen.
7. Të shpjegojnë modelet e sotme të ruajtjes së ekuilibrave në trinomin: mjedis natyror-popullsi-zhvillim ekonomik.
8. Të kuptojnë shkaqet e degradimit dhe të ndotjes së mjedisit dhe modelet e përparuara për rregullimin dhe organizimin hapësinor të vendbanimeve dhe objekteve ekonomike.
9. Të analizojnë për çdo rajon dhe vend të studiuar lidhjet e ndërsjella ndërmjet faktorëve natyrorë e socialekonomikë.
10. Të përdorin e të organizojnë të dhënat e ndryshme që marrin nga mjetet e informacionit masiv, për të demonstruar dhe për të kuptuar më mirë dukuritë dhe proceset gjeografike.
11. Të përdorin shprehjet praktike në ndërtimin e grafikëve, diagrameve, skicave, matjeve dhe lokalizimeve në hartë etj.
12. Të organizojnë udhëtime imagjinare, konkurse me karakter gjeografik, të përgatisin albume për rajone e vende të veçanta etj.

IV. PËRMBAJTJA E LËNDËS

Programi sintetik

35 javë x 2 orë në javë	70 orë
Njohuri të reja	50 orë
Punë praktike	11 orë
Përsëritje	7 orë
Në dispozicion	2 orë

Programi tematik

I. NATYRA DHE POPULLSIA	(12 orë)	10T + 2PP
II. GJEOGRAFIA POLITIKE DHE EKONOMIKE	(10 orë)	8T + 2PP
III. EVROPA PERËNDIMORE E VERIORE	(14 orë)	12T + 2PP
IV. EVROPA QENDRORE	(5 orë)	4T + 1PP
V. EVROPA LINDORE	(5 orë)	4T + 1PP
VI. EVROPA JUGORE	(3 orë)	2T + 1PP
VII. BALLKANI	(12 orë)	10T + 2PP

Programi analitik

I. NATYRA DHE POPULLSIA (12 orë) 10T + 2PP

1. Identiteti kulturor dhe historik i Evropës
2. Veçoritë e relievit dhe të hidrografisë
3. Klima dhe mjediset jetësore. Zona mesdhetare
4. Zona atlantike
5. Zona subkontinentale
6. Zona kontinentale
7. Rajonet e ftohta
8. Veçoritë e përgjithshme gjeografike të popullsisë
9. Gjuhët dhe besimet
10. Lëvizjet migratore
11. Punë praktike: Harta e veçorive natyrore
12. Punë praktike: Harta e popullsisë

II. GJEOGRAFIA POLITIKE DHE EKONOMIKE (10 orë) 8T + 2PP

1. Bashkimi Evropian – etapat e integrimit
2. Vendet e BE
3. Organizmat politikë të BE
4. Problemet ekonomike e politike
5. Gjeografia e bujqësisë
6. Gjeografia e industrisë
7. Gjeografia e transportit
8. Gjeografia e tregtisë dhe turizmit
9. Punë praktike: Organizmat politikë dhe ekonomikë
10. Punë praktike: Harta ekonomike tematike

III. EVROPA PERËNDIMORE E VERIORE (14 orë) 12T + 2PP

1. Vështrim i përgjithshëm
2. Popullsia dhe harta politike
3. Ekonomia dhe transporti
4. Franca dhe Monako
5. Vendet e Beneluksit. Belgjika
6. Holanda dhe Luksenburgu
7. Gjermania
8. Vendet alpine. Zvicra, Austria dhe Lihtenshtejni
9. Mbretëria e Bashkuar
10. Irlanda
11. Vendet Skandinave. Danimarka e Islanda
12. Norvegjia, Suedia e Finlanda
13. Punë praktike: Harta e veçorive natyrore
14. Punë praktike: Harta politike dhe ekonomike

IV. EVROPA QENDRORE (5 orë) 4T + 1PP

1. *Vështrim i përgjithshëm*
2. *Vendet Baltike. Lituania, Letonia e Estonia*
3. *Polonia e Hungaria*
4. *Çekia e Sllovakia*
5. *Punë praktike: Harta fizike dhe ekonomike*

V. EVROPA LINDORE (5 orë) 4T + 1PP

1. *Vështrim i përgjithshëm i KShP*
2. *Rusia*
3. *Vendet evropiane të KShP. Ukrahina*
4. *Biellorusia e Moldavia*
6. *Punë praktike: Harta fizike dhe ekonomike*

VI. EVROPA JUGORE (3 orë) 2T + 1PP

1. *Italia e Vatikani*
2. *Vendet Iberike. Spanja, Portugalia e Andora*
7. *Punë praktike: Harta fizike dhe ekonomike*

VII. BALLKANI (12 orë) 10T+ 2PP

1. *Vështrim i përgjithshëm*
2. *Kosova*
3. *Sllovenia*
4. *Kroacia*
5. *Bosnja dhe Hercegovina*
6. *Serbia – Mali i Zi*
7. *Maqedonia*
8. *Greqia*
9. *Bullgaria*
10. *Rumania*
11. *Punë praktike: Harta e veçorive natyrore*
12. *Punë praktike: Harta politike dhe ekonomike*

V. METODOLOGJIA E TË MËSUARIT

Gjeografia e Evropës të krijon mundësi të gjera për zbatimin e metodave, të teknikave e strategjive bashkëkohore gjatë procesit mësimor-edukativ. Por, arritja e suksesit varet nga shkalla e kualifikimit metodiko-shkencor të mësuesit, përkushtimi e pasioni i tij për lëndën, ndërthurja e formave tradicionale me format e reja, baza materiale didaktike etj.

Metodat bazë mbeten shpjegimi dhe biseda, të gërshetuara me përshkrimin dhe demonstrimin si aspekte të veçanta dhe të domosdoshme në konkretizimin e orës së mësimin të gjeografisë.

Pa përsosur metodën e shpjegimit, do të ishte e vështirë për mësuesin të forconte e të nguliste qartë dhe saktë përmbajtjen e materialit lëndor, të formonte koncepte të drejta e të zgjeronte horizontin gjeografik të nxënësit. Përkundrazi biseda, pavarësisht nga ruajtja e traditave gjatë procedimit metodik, tashmë mund të zgjerohet me tematika bashkëkohore, siç është rasti i breinstomingut (vetëm për temat ku mësuesi mendon se nxënësi ka njohuri paraprake). Kjo arrihet në fund të asaj që e quajmë “Stuhi mendimesh”. Të zbatueshme janë edhe metodat kërkimore e problemore, si hapi i parë paraprak në hulumtimet e nxënësve për zgjidhje që kërkojnë përgjigje të pavarura ose në grupe. Edhe këto forma do të ishin mjaft efikase në rast se harmonizohen me teknikat bashkëkohore të shprehura në punën me grupe nëpërmjet strategjive të reja, si: “Mësimi zbulues”, “Diskutimi që zgjidh problemin” etj.

Metoda që përdor mësuesi, nuk mund të jetë me rendimentin e duhur pa mbështetjen e mjeteve didaktike, ku vendin kryesor e zënë hartat e llojeve e shkallëve të ndryshme, atlase, globe, skica, grafikë, këndi i literaturës gjeografike etj. Këto varen nga gjendja e bazës materiale që ka shkolla, por jo pak edhe nga përpjekjet e interesimi i mësuesit në grumbullimin e sistemin e mjeteve, që sigurohen nga ndihmat, prindërit, nxënësit, komuniteti, bordi i shkollës etj.

VI. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT

Realizimi i përshkallëzuar i programit kërkon zgjedhjen e formave dhe të teknikave bashkëkohore të vlerësimit për të kontrolluar shkallën e përvetësimit të dijeve të nxënësve. Tashmë përsosja e këtyre teknikave ka çuar në verifikimin më objektiv të përgatitjes, ndjekjen hap pas hapi të ecurisë së përparimit të nxënësve, shtimin e kontroleve përmes ndërtimit të testeve, zgjidhjeve të detyrave, ushtrimeve, punës me hartën, punëve praktike etj. Të gjitha këto shihen të zbatueshme në lëndën e gjeografisë nëse mësuesi di të nxjerrë në pah vlerësimin e të nxënësve, si kusht paraprak për të rritur kërkesat e tij sasiore (përqindjen e kalueshmërisë) dhe cilësinë e notës mesatare.

Kontrolli i njohurive të jetë sistematik dhe i pandërprerë gjatë gjithë vitit shkollor. Ai realizohet me gojë e me shkrim.

Nga shkalla e hartimit dhe e drejtimit të pyetjeve varen përgjigjet e nxënësve tanë, ndaj mësuesi duhet të përqendrohet në mundësi të klasifikimit të sferës njohëse nëpërmjet gjashtë niveleve të taksonomisë së Blumit si:

1. Njohja
2. Kuptimi
3. Zbatimi
4. Analiza
5. Sinteza
6. Vlerësimi

Në një shkallë të mjaftueshme, matja e përfundimeve arrihet edhe nga njohja e hartimit dhe e ndërtimit të testeve. Me rëndësi mbetet kontrolli me shkrim apo testimi në mësimdhënie.

Për vetë përmbajtjen e programit dhe të lëndës së gjeografisë, testet mund të zbatohen në tri llojet e tyre, të cila u përgjigjen qëllimeve të caktuara:

1. Testim për të vlerësuar nivelin fillesar të njohurive, pra një verifikim i dijeve të përvetësuar nga viti i kaluar.
2. Testim gjatë mësimdhënies me objektiv kryesor përparimin e nxënësve.
3. Testim në përfundim të mësimdhënies për të kontrolluar dhe për të vlerësuar përvetësimin e disa temave, të kapitujve në përfundim të semestrit dhe të vitit shkollor.

VII. UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

1. *Në programin sintetik* është përcaktuar numri i orëve të përsëritjes dhe të dispozicionit. Shpërndarja e këtyre orëve në planin semestral e vjetor është e drejtë e mësuesve.

2. *Në programin analitik* është përcaktuar numri i orëve për çdo kapitull. Mësuesit janë të lirë të planifikojnë shpërndarjen e orëve për temat e veçanta brenda një kapitulli, por pa cënuar arritjen e objektivave lëndorë nga nxënësit.

3. *Ky program zbatohet edhe në shkollat 9-vjeçare pa shkëputje nga puna.*

KRITERE PËR HARTIMIN E TEKSTIT TË GJEOGRAFISË PËR KLASËN E SHTATË

Përveç kërkesave që parashtrihen në këtë program, puna e institucioneve, e grupeve të autorëve (autor i vetëm) që do të marrin përsipër hartimin e teksteve, të përqendrohet edhe në plotësimin e disa kriterëve të tjera që kanë të bëjnë me këndvështrime të përgjithshme dhe më specifike shkencore apo didaktike, të cilat do të paraqiten në vijim.

I. PARIME TË PËRGJITHSHME

Teksti shkollor ka qenë dhe vazhdon të jetë instrumenti më efektiv i procesit mësimor. Për këtë arsye, tekstet e nxënësit të paraqesin veçori si në trajtimet konceptuale, ashtu edhe në formën e paraqitjes.

Hartimi i teksteve është proces. Ai duhet:

- ◆ Të bazohet dhe të jetë në koherencë të plotë me paketën zyrtare të lëndës shkollore dhe në veçanti me programin e reformuar dhe standardet lëndore;
- ◆ Të marrë parasysh përvojën e deritanishme të shkollës sonë dhe përvojat pozitive të vendeve të tjera;
- ◆ Të mbështetet në përvojat e praktikës së drejtpërdrejtë shkollore, duke përdorur metoda të ndryshme për tërheqjen e mendimit të nxënësve dhe mësuesve në këtë nivel;
- ◆ Të respektojë veçoritë e zhvillimit mendor dhe fizik të fëmijës;
- ◆ Të synojë nxitjen e ideve të reja në procesin e mësimdhënies dhe të nxënësit në lëndën e edukimit muzikor;
- ◆ Të synojë realizimin e një dokumenti fleksibël, që i lë vend mësuesit për zhvillime krijuese si në përmbajtje, ashtu edhe nga ana metodike.

II. KRITERE PËR HARTIMIN E TEKSTIT TË LËNDËS SË GJEOGRAFISË

Teksti i lëndës së gjeografisë, synon ndër të tjera, të krijojë në klasë, në miniaturë, një mjedis të përshtatshëm dhe motivues për përvetësimin nga nxënësit të njohurive gjeografike. Ai duhet të krijojë mundësinë jo vetëm të bashkëpunimit krijues të nxënësve me njëri-tjetrin, por edhe të bashkëpunimit ndërmjet mësuesve dhe nxënësve, madje më gjerë, bashkëpunimin e mjedisit shkollor dhe jashtëshkollor.

Teksti i lëndës së gjeografisë-7 të jetë *në përputhje me programin konkret të miratuar nga MASH Ai* të përmbushë të gjithë objektivat mësimorë e pedagogjikë që përmbahen në të. Në këtë mënyrë teksti do t'u përbahe qëllimeve të sistemit arsimor, në përgjithësi, dhe të programit, në mënyrë të veçantë. Kjo gjë nënkupton mbajtjen parasysh të qëllimeve në dy nivele:

1. *të qëllimeve të shprehura hapur* në program. Kjo do të thotë që në tekst të përfshihen ato informacione dhe të mundësohen ato veprimtari që synojnë të arrihet qëllimi i shprehur në program;
2. *qëllimeve të nënkuptuara*. Kjo do të thotë që autorët e teksteve të studiojnë dhe të zbulojnë atë sistem vlerash, në të cilat mbështetet një sistem arsimor demokratik. Teksti nga ana e tij, si i tërë, të mundësojë realizimin e qëllimeve të tilla, të cilat në shumë raste janë edhe themelore.

Teksti nuk është përkthim i programit, i cili ka karakter sa detyrues aq edhe udhëzues. Këtë autorët duhet ta mbajnë parasysh. Këta të fundit, duke patur një konceptim të qartë të procesit mësimor dhe duke patur perceptimin e tyre për përmbajtjen e lëndës, mund të kthehen në një faktor përparimi e modernizimi në mësimdhënien e lëndës së gjeografisë. Në këtë drejtim, autorët mund të shfrytëzojnë:

- ◆ Hapësirat dhe fleksibilitetin e programit (orët në dispozicion ose përsëritjet);
- ◆ Aparatin pedagogjik të tekstit, i cili më shumë se çdo gjë tjetër kufizon ose zgjeron mundësitë e përvetësimit të objektivave të lëndës.

Teksti të krijojë mundësi për të sjellë në klasë shembuj konkretë nga rajoni i përfshirë në studim.

Nga pikëpamja pedagogjike, teksti të mundësojë realizimin e objektivave në *fushën e njohurive, të shprehive dhe të qëndrimeve*. Kjo do të thotë që teksti duhet të ofrojë, si për nxënësit ashtu edhe për mësuesit, *krijimin e situatave mësimore që mundësojnë realizimin e objektivave të mësipërm*. Këtu duhet të kujtojmë se veprimtaritë praktike nuk mund të shihen të ndara nga njohuritë gjeografike. Për këtë arsye autori (autorët) e tekstit të parashikojë ato njohuri që mundësojnë realizimin në tërësinë e tyre të synimeve dhe të objektivave të lëndës.

Sistemi i pyetjeve në fund të njësive mësimore (autorët mund të përdorin edhe forma të tjera), të krijojë mundësinë që nxënësit:

- Në mënyrë të pavarur të përvetësojë informacionin e tekstit;
- Të dallojnë atë çka është thelbësore nga ajo që nuk është e tillë, në varësi të objektivave të njësive mësimore dhe të objektivave të programit;
- Të krijojë mendimin dhe qëndrimet e tij të pavarura, të mbështetura me argumente, si dhe të pranojë, të respektojë dhe të marrë parasysh argumentet e të tjerëve;

Mësuesit :

- Të zgjedhin metodat ndërvepruese më të përshtatshme për realizimin e objektivave të lëndës së gjeografisë;
- Të planifikojnë më mirë orën mësimore;
- Të mundësojnë vënien e nxënësve në kushte të barabarta të nxëni;
- Të mundësojnë nxënësit të përqendrohen në çështjet kryesore të temës mësimore;
- Të mundësojnë nxënësit të shfrytëzojnë njohuritë e tyre paraprake ose të përvetësuar gjatë procesit mësimor që janë të domosdoshme për përvetësimin e njohurive dhe të shprehive të reja;
- Të vlerësojnë realizimin e objektivave të njësive mësimore dhe nivelet e përvetësimit të tyre nga nxënësit etj

- ◆ Teksti të përmbajë mësimet ose struktura mësimi të qarta, në formën e njësive mësimore, për të arritur objektiva të qarta mësimore në përputhje me programin ose me standardet lëndore.
- ◆ Po kështu, në tekst mund të shfrytëzohet ose të nxitet edhe mundësia e marrjes së informacioneve të caktuara shpesh nga burime të tjera informacioni (atlase, harta, foto, albume historike etj.), gjë që do të bënte tekstin ose njësinë

mësimore më fleksibël dhe më pak monotone, duke rritur edhe mundësitë e punës së pavarur e kërkimore të nxënësve.

- ◆ Gjuha e teksteve të jetë e thjeshtë, e kuptueshme, e pangarkuar me terma e terminologji të huaja ose që bartin kuptime të ndryshme.
- ◆ Nëse në tekst përdoren ilustrime, ato të bartin vlera kuptimore dhe emocionale që lidhen ngushtë me motivimin e nxënësve, me përmbajtjen e njësisë mësimore ose me objektiva të tjerë të programit.
- ◆ Nga pikëpamja sasiore, autorët e teksteve të shmangin informacionet e tepërta, të përsëritura etj., që shpeshherë krijojnë mbingarkesë tek nxënësit, të cilët jo gjithmonë janë në gjendje të dallojnë *informacionin kryesor* nga ai që nuk është i tillë në raport me kërkesat e programit ose të njësisë mësimore.
- ◆ Autorët të bëjnë kujdes që të mos krijojnë mbingarkesë edhe në dhënien e koncepteve. Mbingarkesa krijohet jo vetëm nga numri i madh i koncepteve që jepen në një njësi mësimore, por edhe nga pamundësia e sqarimit në kushtet e kufizimit sasior (pra informacioni) dhe kohor të njësisë mësimore. Informacionet shtesë (ilustrimet, fotot, tekstet, grafikët etj.) t'i shërbejnë sqarimit më të mirë të koncepteve.
- ◆ Njësia mësimore e tekstit të ketë një strukturë që të lejojë përmbushjen e funksioneve të tekstit, si dhe pasqyrimin e veçorive të përmbajtjes së temave të veçanta.
- ◆ Struktura e ndarjeve të tekstit, si dhe struktura e njësisë mësimore të tekstit (p.sh., tema) të jenë të njësuara gjatë gjithë tekstit.
- ◆ Faqosja e elementeve të ndarjeve mësimore (tituj, tekste, figura, pyetësorë, detyra, ushtrime etj.) të jetë tërheqëse dhe e mbështetur në procedurën logjike të shtjellimit të lëndës, në përgjithësi, dhe temës, në veçanti.
- ◆ Përdorimi i hapësirave, nënvizimeve, qartësimeve, ngjyrave etj., të jetë i pranueshëm dhe në shërbim të çështjes që trajtohet.

Teksti të jetë me katër ngjyra.
Teksti të ketë 140 faqe A4
Formati të jetë 260 x 200 mm.